

**POLICË SIGURIMI PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA**  
Third Party Liability Insurance Policy

<b>Policë nr. 5372</b> Policy nr.	<b>Tirane ,me . 31/03/2026</b>
--------------------------------------	--------------------------------

**I SIGURUARI (Detail of insured )**

<b>Emri i të Sigurvearit(Name Surname )</b>	Albanian Trip shpk
<b>Adresa( Address )</b>	Rr. E Dibres NR 261/1
<b>Nipt /Administrator</b>	L72314029D /Elton Çausi
<b>Përshkrimi i Biznesit(Description of the business)</b>	Operator turistik

**INTERESI I SIGURUAR**

<i>Pergjegjesia ndaj paleve te treta</i> Third Party Liability
---

**LIMITI I DËMSHPËRBLIMIT**

Limit of indemnity

<b>Limiti për çdo një dëm</b> Limit of indemnity for accurance	10,000 euro (dhjetemije)
<b>Limiti në agregat</b> Limit of indemnity aggregate	50,000 euro (pesedhjetemije)

**PJESA E ZBRITSHME**

DEDUCTIBLE

500 euro per cdo ngjarje dhe 1000 Euro ne agregat
---

**PERIUDHA E SIGURIMIT**

Insurance validity

<b>Kohezgjatja e sigurimit</b> Insurance validity	31/03/2026- 30/03/2027
--	------------------------

**PRIMI**

<b>Primi( Premium)</b>	140 Euro	14Euro (tax)	154 Euro
<b>Primi Total: 154Euro</b>			

Bashkëngjitur dhe pjesë e Policës së Sigurimit:

1. Kushte të Përgjithshme të Përgjegjësisë
2. Pyetesori

**I SIGURUARI**

Elton ÇAUSHI  
Administrator

Lëshuar në Tirane , me 31/03/2026

**SIGURUESI**

**INSIG SH.A.**



## Polica e Sigurimit te Pergjegjesise Publike ndaj Paleve te Treta

### I. Dispozita te Pergjithshme

Kushtet e pergjithshme te Kontrates se Sigurimit per Pergjegjesine e Pergjithshme, ketu me poshte do te quhen **“Kushtet e Sigurimit”**.

Shoqeria e Sigurimeve INSIG Sh.a. ketu me poshte do te quhet **“Siguruesi”**.

Personi fizik ose juridik, interesi i te cilit do te mbulohet ne sigurim sipas ketyre Kushteve te Sigurimit te Pergjegjesise se Pergjithshme, ketu me poshte do te quhet **“I Siguruari”**.

Kontrata e Sigurimit per Pergjegjesine e Pergjithshme, lidhur ndermjet Siguruesit dhe te Siguararit ketu me poshte do te quhet **“ Polica e Sigurimit”**.

### Shtese personash te siguaruar

Me kusht qe te jete kerkuar dhe te jete specifikuar ne formular, fjala **“I Siguruari”** do te perfshije sa me poshte:

- a. cdo drejtues ose partner te te Siguararit ne cilesite perkatese te tij si i tille.
- b. cdo person te punesuar nga i Siguruari sipas nje kontrate sherbimi apo periudhe punesimi ose prove ne cilesite perkatese te tij si i tille.
- c. cdo zyrtar ose punonjes i organizatave sportive dhe shoqerore ose mbarevajtje te te Siguararit ose te sherbimit ne rast zjarri ose sherbimeve te ambulances ne cilesite perkatese te tij.
- d. cdo pale e trete qe ka te drejten ligjore te kerkoje demshperblim per deme te kryera ndaj te Siguararit ne lidhje me cdo Ngjarje te Siguaruar.

### II. Marreveshja Siguruese

Duke iu referuar kushteve, kufizimeve, perjashtimeve dhe kushteve te tjera qe permban kjo police dhe formulari dhe me kusht qe I Siguruari te kete paguar dhe te kete rene dakord per te paguar primin (i quajtur ketej e tutje **“Siguruesi”**) bie dakord qe te demshperbleje te Siguararin per:

- Te gjitha shumat per te cilat i Siguruari do te behet ligjerisht pergjegjes te paguaje per kompesim, dhe kostot e demeve dhe shpenzimeve ne lidhje me ndonje Ngjarje te Siguaruar per te cilen kjo Police zbatohet, brenda limiteve te demshperblimit, limiteve te poshteshenuara dhe ne lidhje me biznesin sic eshte pershkruar ne formular, perfshire njesine, te marre ose dhene me qera ose ne pronesi te te Siguararit
- Te gjitha shpenzimet per mosmarreveshjet, te kryera me miratimin paraprak me shkrim te Siguruesit ne lidhje me ndonje kerkese per demshperblim ndaj te Siguararit, kerkese per te cilen zbatohet demshperblimi i shprehur ne kete police.

### III. Ngjarjet e Siguruara

Ngjarjet e meposhtme jane te siguruara nga Siguruesi ne qofte se ato do te ndodhin gjate Periudhes se Demshperblimit te siguaruar nga kjo police dhe kur i Siguruari t'ia kete raportuar ato Siguruesit jo me vone se data e perfundimit te periudhes se sigurimit te specifikuar ne police.

Cdo lloj demi shendetesor (perfshire vdekjen ose semundjen) i cdo personi qe konsiderohet si **“I Siguaruar”** ne kete police.



Demtim ose humbje fizike e cdo lloj pasurie reale, te tundshme ose te patundshme qe zoterohet nga cdo person qe konsiderohet "I Siguruar" ne kete police.

#### **IV. Limiti i demshperblimit**

##### **a) Per cdo ngjarje**

Pergjegjesia e Siguruesit per te gjitha kostot e kompensimeve dhe shpenzimet e pagueshme cdo pretenduesi ose nje numri pretenduesish per cdo ngjarje, nuk do te kaloje shumen e percaktuar ne formular si Limiti i Demshperblimit per cdo Ngjarje.

##### **b) Klauzola e serise se demeve**

Per te percaktuar kufirin e pergjegjesise se Siguruesit ne lidhje me Ngjarjet e Siguruara, te gjitha demet apo humbjet qe kane ardhur si rezultat i ekspozimit te vazhduar ose te perseritur te kushteve thelbesisht te njejta te demshme do te konsiderehen si nje ngjarje e vetme dhe se kane ndodhur gjate Periudhes se Demshperblimit ne te cilen ka ndodhur demi i pare.

##### **c) Limiti agregat**

Pergjegjesia e Siguruesit per te gjitha kostot dhe kompensimet dhe shpenzimet e pagueshme ne lidhje me te gjitha ngjarjet e ndodhura gjate cdo periudhe demshperblimi, nuk do te kaloje shumen e percaktuar ne formular si Limiti Agregat.

Demshperblimi per cdo ngjarje per pergjegjesine ne lidhje me ngarkimin ose shkarkimin nga ose te nje mjeti, karrocierie ose anije, hidroplani ose aeroplani, nuk duhet te kaloje shumen maksimale te percaktuar ne formular.


#### **V. Kufizimet territoriale/ Juridiksioni**

Territori i polices nenkupton SHQIPERINE (vendi ku eshte vendosur INSIG)  
Polica i nenshtrohet ligjit/juridiksionit te SHQIPERISE.

#### **VI. Perjashtime**

Kjo police nuk do te zbatohet per:

1. pergjegjesine ne lidhje me demtimet trupore ose semundjeve te cdo personi sipas nje kontrate punesimi ose marrje ne prove me te Siguararin, nese nje pergjegjesi e tille ka lidhje me demtimet trupore ose semundjeve qe ndodhin pergjate kryerjes se punes, ne rast se ngjarjet jane te mbuluara nga sigurimet shoqerore gjate periudhes se punesimit.
2. cdo sherbim ose keshille profesionale, sherbim ose trajtim i dhene, i administruar ose neglizhuar nga i Siguruari (pergjegjesia profesionale)
3. pergjegjesia per cdo humbje financiare qe nuk vjen si rezultat i demtimeve materiale ose shendetesore sic percaktohet ne seksionin III.
4. cdo pergjegjesi e cfaredo lloj nature qe shkaktohet, vjen ose ndikon, direkt ose indirekt nga ndotja e ajrit, ujit ose tokes.
5. pergjegjesia ne lidhje me humbjen ose demtimin e pasurise:
  - a) qe i perket te Siguararit
  - b) perpunohet nga/ose eshte nen kujdesin, ruajtjen, kontrollin e te Siguararit ose cdo personi tjeter te punesuar nga/ose qe punon per te Siguararin.
6. Pergjegjesia per humbje ose demtime te pasurise qe rrjedhin nga zjarri, rrufeja ose eksplozioni ne ambientet e te Siguararit.



7. Kerkesat per demshperblim ne lidhje me vonesen e realizimit ose plotesimit te kontratave qe jane lidhur.
8. pergjegjesia per demtime ne punen ose ne artikuj te prodhuar ose furnizuar nga i Siguruari, (ose nga ndonje pale e trete ne emer te te Siguararit) qe shkaktohen nga nje shkak i brendshem ne prodhim ose ne furnizim.
9. Pergjegjesia ne lidhje me kthimin, terheqjen nga tregu, rivendosjen, riparimin, montimin, ose koston e/ose zvogelimin ne vlere te ndonje malli ose mallrave te furnizuar, instaluar ose montuar nga i Siguruari nese pergjegjesi te tilla rrjedhin nga ndonje defekt i brendshem ose nga natyra e demshme e papershtatshme.
10. Pergjegesia ne lidhje me ndonje artikull ose mall te furnizuar, instaluar, montuar nga i Siguruari per qellime aviacioni ose anijeje, kozmike ose industrise se automobilave (perfshire cdo lloj pjese kembimi ose perberese)
11. pergjegjesia ne lidhje me cdo ngjarje qe vjen si rrjedhoje e nje veprimi te qellimshem dhe te pandershem ose neglizhence nga ana e te Siguararit dhe qe duhej te parashikoheshin nga ana e te Siguararit duke marre parasysh natyren dhe rrethanat e ketij veprimi ose neglizhence.
12. Pergjegjesia marre persiper nga i Siguruari sipas nje kontrate pune ose ndonje lloj tjeter marreveshjeje, pervec rastit kur pergjegjesi te tilla do t'i jene ngarkuar te Siguararit edhe ne mungese te kontratave ose marreveshjeve te tjera.
13. Cdo pergjegjesi e cfaredo natyre qe direkt ose indirekt eshte shkaktuar nga/ose qe rrjedh nga:
  - a) rrezatimi ose ndotje jonizuese nga radioaktiviteti prej karburanteve berthamore ose prej rrjedhjeve berthamore ose djegia e karburanteve berthamore.
  - b) eksplozivet toksike radioaktive ose lende te tjera te rrezikshme te perberjeve eksplozive berthamore ose pjeseve perberese te tyre.
  - c) asbestosi ose semundje te tjera qe lidhen me te (perfshire kancerin) qe rrjedhin nga egzistenca , prodhimi, trajtimi, perpunimi, shitja, shperndarja, magazinimi, depozitimi ose perdorimi i asbestit, dhe/ose produkteve qe permbajne asbest.
14. Pergjegjesia per cdo pasoje te luftes, pushtimit, veprimeve te armiqve te jashtem (ne lufte ose jo), lufta civile, revolucioni, nderhyrja ushtarake, uzurpimi me fuqi territoriste, vandalizmi ose sabotimi.
15. Gjobat, masat ndeshkuese.

## VII. Pagesa e Primit


### Fillimi dhe periudha e sigurimit

I Siguruari eshte i detyruar te paguaje, tek Siguruesi ose tek qendra e agjencise ne te cilen eshte neshkruar kontrata me afatet perkatese, te njejtin prim te caktuar ne kontrate. Vjelja e primeve ne vazhdimesi realizohet ne vendbanimin e te Siguararit, ai nuk mundet ne asnje menyre te perjashtohet nga nje detyrim i tille. Kesti i pare duhet te jete paguar me dhenien (dorezimin) e kontrates. Kestet pasardhese paguhen me dhenien e deshmive te pagesave (faturave) qe duhet te permbajne firmen e te Siguararit.

Sigurimi hyn ne fuqi ne oren 24 °° te dites se shenuar ne police, me kusht qe primi te jete paguar, ne rast te kundert hyn ne fuqi ne oren 24 °° te dites se kryerjes se pageses.

Primi mbetet i pezulluar ne ditën e afatit te caktuar ne kontrate.

Per primet pasuese, se pari eshte lejuar kufiri per t'u respektuar prej 15 diteve, gjate se cilave sigurimi mbetet pezull, dhe rihyn ne fuqi ne oren 24 °° te dites se pagimit te primit duke mbetur te pandryshuar afatet e percaktuara ne kontrate.



Gjate 15 diteve te mesiperme, Siguruesi ka te drejten te deklaroje me leter rekomande, zgjidhjen e kontrates, duke mbajtur te drejten e primeve te skaduara dhe te kerkoje ekzekutimin ligjerisht. Primi eshte gjithmone vendimtar per periudhen e sigurimit prej nje viti sepse zgjidh ceshjet e kontrates.

### **Axhustimi i Primit**

Primi, i caktuar ne baze te elementeve te rrezeve te ndryshueshem, parapaguhet ne menyre provizore ne shumen qe rrjedh nga llogaritjet ne police dhe rregullohet ne fund te cdo periudhe sigurimi vjetor ose me te shkurter te kontrates, sipas ndryshimeve te ndodhura gjate se njeites periudhe, ne elementet e marre si baze per llogaritjen e primit duke mos ndryshuar primin minimal te percaktuar ne police.

Per kete qellim Brenda 60 diteve nga fundi i cdo periudhe vjetore te sigurimit ose te nje kohezgajtje me te shkurter te kontrates, I Siguruari duhet te njoftoje me shkrim Siguruesin per te dhenat e meposhtme:

Informacion mbi te elemente te ndryshem te shenuar ne police. Kjo diference mes te aktiveve dhe shpenzimeve, qe rezulton prej rregullimit te primit duhet qe te paguhet ne 30 ditet e mepasme pas njoftimit te Siguruesit. Nese i Siguruari nuk kryen ne kohen e caktuar njoftimin e te dhenave te mesiperme ne kohen e duhur (Brenda limiteve kohore te percaktuara) ose pagimin e differences mes te ardhurave dhe shpenzimeve, Siguruesi mund te caktojte nje date tjeter afat kohor, jo me te vogel se 15 dite, pas se cilit primi i parapaguar ne menyre provizore per keset pasardhese konsiderohet per llogari ose garanci per ate periudhe sigurimi vjetor per te cilin nuk eshte aplikuar rregullimi ose pagimi i differences mes te ardhurave dhe shpenzimeve, garancia mbetet e anuluar deri ne oren 24<sup>oo</sup> te dites ne te cilen i Siguruari ka permbushur detyrimet e tij, pa prekur te drejten e shoqerise per te vepruar juridikisht ose per te deklaruar me leter rekomande zgjidhjen e kontrates.

Per kontratat a anuluar, ne qofte se i Siguruari nuk ploteson detyrimet ne lidhje me rregullimin e primit, Siguruesi duke ndaluar te drejten e saj te vepronte ligjerisht, nuk eshte e detyruar per deme te ndodhura ne periudhen se ciles i referohet mungesa e rregullimit.

Sa here qe sipas nje rregullimi vjetor, bilanci i elementeve te ndryshueshem te rrezikut tejkalon dyfishin e asaj qe eshte marre si baze per percaktimin.

### **IX. Parashikimet dhe procedurat per kerkesat per demshperblim**

1. I Siguruari do te marre te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar dhe per te lehtesuar demtimet trupore, semundjet, humbjet ose demtimet pasurore, te cilat mund te shkaktojne lindjen e nje kerkese per demshperblim sipas kesaj police.
2. Cdo ngjarje, e cila do te sillte lindjen e nje kerkese per demshperblim sipas polices, duhet t'i raportohet me shkrim Siguruesit sa me shpejt qe te jete e mundur. Asnje korrigjim ose riparim nuk do te behet perderisa Siguruesi te beje investigimin. I Siguruari duhet te jape njoftim te menjehershem per cdo ndjekjeje penale per plagosje fatale ose procedura civile ne lidhje me ngjarjen, dhe do t'i dergoje menjehere Siguruesit te gjitha dokumentat qe kane te bejne me ceshtjen.
3. Asnje pranim i pergjegjesise, premtim ose pagese nuk do te behet pa miratimin me shkrim te Siguruesit. Siguruesi do te kete te drejten sipas zgjidhjes se tij, te marre persiper dhe te drejtoje ne emer te Siguruarit mbrojtjen dhe rregullimin e cdo kerkese per demshperblim dhe te procedoje me shpenzimet dhe ne te miren e tij cdo pretendim per demshperblim ose deme ndaj cdo personi tjeter dhe I Siguruari duhet te jape te gjithe informacionin dhe ndihmen e kerkuar. I Siguruari nuk do te jete me pergjegjes per ngjarjen me perjashtim te pagesave per shpenzimet e mosmarreveshjeve te ndodhura me perpara kesaj pagese.
4. Siguruesi mund t'i paguaje te Siguruarit shumen maksimale te pagueshme sipas kesaj police ne lidhje me cdo ngjarje ose cdo shume me te vogel me te cilen mund te mbyllet me marreveshje, pretendimet qe lindin nga nje ngjarje e tille, dhe Siguruesi nuk do te kete pergjegjesi te



mevonshme ne lidhje me ate ngjarje, me perjashtim te pageses se kosmos dhe shpenzimeve te mosmarrveshjeve te shkaktuara me perprara ketyre pagesave.

5. Nese ne kohen e ndonje ngjarjeje ose pretendimi per demshperblim, ekziston nje police tjeter per demshperblim ose sigurim ne favor te /ose, e ndikuar nga/ose ne emer te te Siguararit, e zbatueshme ne te tilla ngjarje, Siguruesi nuk do te jete pergjegjes sipas kesaj police te demshperbleje te Siguararin ne lidhje me kete ngjarje ose pretendim, me perjashtim te pjeses qe tejkalon shumen e cila do te ishte e pagueshme sipas demshperblimit ose sigurimit tjeter sikur kjo police te mos ishte ne fuqi.

## **X. Kushte te pergjithshme**

1. Kjo police, shtojcat e poshteshenuara, formulari dhe kushtet e vecanta do te lexohen se bashku si nje kontrate, dhe cdo fjale ose shprehej per te cilen eshte atribuar nje kuptim i vecante ne cdo pjese te kesaj police, formularit ose kushteve te vecanta, do te mbaje po ate kuptim kudo qe shfaqet.
2. Nese primi per kete police ka qene llogaritur sipas nje vleresimi te dhene nga i Siguarari, ky do te mbaje shenime te sakta per gjithe detajet perkatese dhe do ta lejoje te Siguararin ne cdo moment te arsyeshem te kohes te inspektoje shenime te tilla dhe me mbarimin e cdo periudhe demshperblimi, do t'i dergoje Siguruesit gjendjen e sakte te rregulluar, keshtu qe per kete periudhe do te llogaritet primi dhe diferenca e paguar nga i Siguarari si mbulim.
3. Siguruesi mundet ne cdo kohe te arsyeshme te inspektoje cdo njesi dhe ne cdo rast te ndonje defekti ose rreziku te paraqitur, Siguruesi mund te jape njoftim me shkrim te Siguararit per rastet kur e gjithe pergjegjesia e Siguruesit per arsye te defekteve dhe rreziqeve te tilla, do te pezullohet.
4. Nese ne nje kohe te caktuar do te shfaqet materialisht xxx qe do te ndikoje ne rrezikun e siguruar, I Siguarari duhet, brenda 7 diteve te jape njoftim me shkrim siguruesit.
5. Vezhgimi dhe plotesimi i detyrueshem i kushteve, klauzolave e parashikimeve persa ato lidhen me ndonje gje qe duhet kryer ose plotesuar nga i Siguarari dhe vertetesia e pohimeve te bera prej tij ne kerkesen per sigurim (e cila duhet te jete baza e kesaj kontrate) do te jene kushte paresore per pergjegjesi te te Siguararit.

## **XI. Periudha e demshperblimit**

Periudha e demshperblimit eshte nje vit ne perputhje me percaktimet e shenuara ne formularin e polices se sigurimit dhe nenit VII Pagesa e Primit.

### **Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Për çdo mosmarrëveshje që nuk zgjidhet me mirëkuptim, palët do t'i drejtohen Gjykatës së vendit ku është lëshuar Polica e Sigurimit.

INSIG SHA

